



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 6, datë 25.04.2023

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "PROJEKTI PËR
RIKUALIFIKIMIN E BREGDETIT VLORË-RADHIMË-ORIKUM, LOTI I, II", ME
VENDNDODHJE NË BASHKINË VLORË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të Bashkisë Vlorë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Projekti për rikualifikimin e bregdetit Vlorë – Radhimë - Orikum, Loti I, II", me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me zhvillues Bashkinë Vlorë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
4. Këshilli Kombëtar i Territorit, mund të vijojë me shqyrtimin dhe miratimin e objekteve në kompetencë të tij, brenda gjurmës së projektit për rikualifikimin e bregdetit Vlorë – Radhimë - Orikum, Loti I, II, sipas këtij vendimi, pas marrjes së dakordësisë nga Bashkia Vlorë.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Bashkia Vlorë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 02/04/ 2025